



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 848 /2022

DATA:	07.02.2022
PËR:	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës.
NGA:	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Florim Shkreta
LËNDA:	Shkresë përcjellëse: Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim raportin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2021

Me respekt

Kuvendi i komunës gjatë vitit 2021 ka planifikuar që t'i mbajë dymbëdhjetë mbledhje. Gjatë vitit 2021 ka mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë mbledhje të rregullta, një mbledhje solemne me rastin e "Epopesë" së UÇK"-së dhe mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës në të cilën është bërë konstituimi i kuvendit të komunës dhe betimi i Kryetarit të Komunës z.Mehmet Ballazhi dhe është zgjedhur kryesuesi i kuvendit të komunës z.Florim Shkreta. Pas mbledhjes inauguruese është miratuar edhe përbërja e komitetit për politik e financa dhe përbërja e komitetit për komunitet si komitete obligative të kuvendit të komunës. Kemi pasur dy zëvendësime në kuvendin e komunës njëri ka qenë nga radhët e Lëvizjes Vetë Vendosije, që pas dorëheqjes së z.Akif Shkrte është zëvendësuar nga z.Habib Thaçi, ndërsa nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës ka dhënë dorëheqje z.Avni Hasallari dhe është zëvendësuar nga z.Veton Ballazhi. Mbledhjet e kuvendit vazhdimisht janë monitoruar nga monitoruesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Vlen të theksohet se në bazë të monitorimit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2021 kemi pasur një vendime që është kthyer për rishqyrtim, Vendim për Shfuqizimi i vendimit me numër 01/ Nr.8749/2021 për lopotopët e sektorit politik dhe të punëtorëve të arsimit kuvendit të komunës, kurse të gjitha vendimet tjera që janë marr në kuvendin e komunës kanë qenë në përputhshmëri me ligjin. Gjithashtu mbledhjet janë monitoruar edhe nga OSBE, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të këshillave të fshatrave. Vlen të theksohet se transparenca ka qenë e nivelit mjaft të mirë pasi që mbledhja është thirr me kohë dhe është publikuar në tabelën e shpalljeve.

Bashkëpunimi me kryetarin e komunës dhe me ekzekutivin ka qenë i nivelit shumë të mirë.

Mbledhjet e kuvendit të komunës vazhdimisht sipas rregullores së punës ju ka parapar mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa në të cilat mbledhje në shumicën e rasteve jemi dakorduar unanimitisht për pikat e rendit të punës për kuvend.

Punën e kuvendit të komunës gjatë këtij viti e ka përcjell një frymë e bashkëpunimit si me pozitën ashtu edhe me opozitën por vlen të theksohet se kuvendi i komunës në vitin 2021 ka miratuar buxhetin për vitin 2022.

Mbledhjet e kuvendit kanë qenë të hapura për publikun por edhe pse vazhdimisht i kemi njoftuar qytetarët për një të drejtë të tyre për pjesëmarrje, kemi pas raste ku qytetarët kanë marr pjesë në punën e kuvendit. Na mbetet për detyrë që në vitin 2022 t'i inkurajojmë qytetarët që të marrin pjesë në punimet e kuvendit.

Kuvendi i komunës gjatë vitit 2021 ka miratuar Plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Komunale për vitin 2021 dhe 35 vendime, që në krahasim me vitin e kaluar kuvendi i komunës ka miratuar 37 vendime dhe 5 rregullore.

Në vazhdim kemi paraqitur në formë tabelare të gjitha mbledhjet e kuvendit me pikat e rendit të punës vendimet dhe rregulloret e miratuara.

Nr.	MBLEDHJET E RREGULLTA TË MBAJTURA SIPAS PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2021	RENDI I PUNËS PËR MBLEDHJET E MBAJTURA PËR VITIN 2021	VENDIMET DHE RREGULLORET TË CILAT I KA MIRATUAR KUVENDI I KOMUNËS PËR VITIN 2021
1	Mbledhja e parë e mbajtur me datë: 28.01.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 3. Propozim vendim për ndarjen e bursave për studentë. 4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021. 5. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021. 6. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2020. 7. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/Nr.9228/2020 për ndërrim destinim të pronës. 8. Rregullorja për taksa komunale për vitin 2021. 9. Të ndryshme.	1. Vendim për ndarjen e bursave për studentë. 2. Vendim për planin punës së komitetit për komunitete për vitin 2021. 3. Vendim për planin punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021. 4. Vendim për shfuqizimi i vendimit me numër 01/Nr.9228/2020 për ndërrim destinim të pronës. 5. Plotësim ndryshimi i Rregullorja për taksa komunale për vitin 2021.
2	Mbledhja e dytë e mbajtur me datë: 25.02.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Raporti vjetor i punës së kryetarit të komunës për vitin 2020. 3. Raporti i menaxhimit dhe parandalimit të përhapjes së pandemisë covid 19 në komunën e Hanit të Elezit. 4. Propozim vendim për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh për institucionin parashkollor , dhe SHFMU “Ilaz Thaçi” Hani i Elezit . 5. Raporti financiar për vitin 2020. 6. Propozim vendim për bartjen e të hyrave të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual. 7. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2020. 8. Plani i punës së këshillave lokale të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021. 9. Kërkesë për emërtimin e parkut memorial “Bllaca 99”. 10. Informatë mbi raportin financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2020 Npl “Pastrimi” Sh.a. 11. Të ndryshme.	6. Vendim për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh për institucionin parashkollorë dhe SHFMU “Ilaz Thaçi” Hani i Elezit 7. Vendim për raportin financiar për vitin 2020. 8. Vendim për bartjen e të hyrave të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual. 9. Vendim për raportin i punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.

			10. Vendim për planin e punës së këshillave lokale të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021. 11. Vendim për emërtimin e parkut “Hasan Prishtina” në qendrën perkujtimore “Bllaca 99”.
3	Mbledhja e tretë e mbajtur me datë: 25.03.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 3. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2020. 4. Raportet e punës së katër komiteve konsultative për vitin 2020. 5. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2019. 6. Kërkesë për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale. 7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2020. 8. Njoftim për aktivitetet e këshillave lokale të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020. 9. Kërkesë e z.Ramush Krasniqi. 10. Të ndryshme.	12. Vendim për raportin e punës së komitetit për komunitete për vitin 2020. 13. Vendim për raportin e punës së katër komiteve konsultative për vitin 2020. 14. Vendim për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale. 15. Vendim për dhënin e pëlqimit në parim z. Ramush Krasniqi.
4	Mbledhja e katërt e mbajtur me datë: 29.04.2021	1. Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Habib Thaçi. 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 3. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2021. 5. Informatë për ndarjen e bursave. 6. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a. 7. Kërkesa e z.Sokol Loku për ndërrim destinim të pronës. 8. Propozim vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01.Nr.2010/2021 për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale. 9. Të ndryshme.	16. Vendim për raportin financiar për periudhën Janar – Mars 2021. 17. Vendim për z.Sokol Loku për ndërrim destinim të pronës. 18. Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01.Nr.2010/2021 për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.

5	Mbledhja e pestë e mbajtur me datë: 27.05.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 3. Kërkesa e kompanisë “Elkon” sh.p.k për dhënien e pëlqimit në parim. 4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit. 5. Të ndryshme.	19. Vendim për dhënien e pëlqimit në parim për kompaninë “Elkon” sh.p.k.
6	Mbledhja e gjashtë e mbajtur me datë: 29.06.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 3. Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024. 4. Draft plani lokal i veprimit në mjedis 2021-2026. 5. Informatë për sektorin e emergjencave. 6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre. 7. Të ndryshme.	20. Vendim për kornizën afatmesme buxhetore 2022-2024.
7	Mbledhja e shtatë e mbajtur me datë: 29.07.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Draft plani lokal i veprimit në mjedis 2021-2026. 3. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021. 4. Raporti i auditorit të brendshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2020. 5. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit të brendshëm - 2020. 6. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022. 7. Informatë për raportin e përmbushjes së planit të integritetit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020. 8. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021. 9. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a. 10. Të ndryshme.	21. Vendim për planin lokal të veprimit në mjedis 2021-2026 22. Vendim për raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2021. 23. Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
8	Mbledhja e tetë e mbajtur me datë: 31.08.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 3. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2021. 4. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale. 5. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020. 6. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna	24. Vendim për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

		në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2020. 7. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2020-2021. 8. Informatë për korrje shirjet. 9. Të ndryshme.	
9	Mbledhja e nëntë e mbajtur me datë: 28.10.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 3. Buxheti i komunës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024. 4. Draft plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022. 5. Kërkesa e z.Sherif Lusnjani për ndërrim destinim të pronës. 6. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022. 7. Të ndryshme.	25. Vendim për buxhetin e komunës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024. 26. Vendim për planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2022. 27. Vendim për ndërrim destinim të pronës z.Sherif Lusnjani.
10	Mbledhja e dhjetë e mbajtur me datë: 09.11.2021	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 3. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2021. 4. Vendim mbi caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2022. 5. Plani i biznesit i N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2022. 6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit. 7. Raporti mbi suksesin e arritur për përfundimin e vitit shkollor 2020/2021. 8. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2021 i N.P.L Pastrimi sh.a. 9. Kërkesa e z.Bedri Bushi për ndërrim destinim. 10. Propozim Vendim për lopotopët e sektorit politik dhe të punëtorëve të arsimit. 11. Të ndryshme.	28. Vendim për raportin financiar për periudhën Janar – Shtator 2021. 29. Vendim mbi caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2022. 30. Vendim për planin e biznesit i N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2022. 31. Vendim për ndërrim destinim të pronës z.Bedri Bushi. 32. Vendim për lopotopët e sektorit politik dhe të punëtorëve të arsimit.

	Mbledhja e njëmbëdhjetë me datë: 30.12.2021	1. Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Veton Ballazhi. 2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit. 3. Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për politik e financa. 4. Propozim vendimi për përbërjen e komitetit për komunitete. 5. Propozim vendimi për përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. 6. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/ Nr.8749/2021 për lopotopët e sektorit politik dhe të punëtorëve të arsimit. 7. Të ndryshme.	33. Vendim për përbërjen e komitetit për politik e financa. 34. Vendim për përbërjen e komitetit për komunitete. 35. Vendim për përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. 36. Vendim për Shfuqizimi i vendimit me numër 01/ Nr.8749/2021. për lopotopët e sektorit politik dhe të punëtorëve të arsimit.
--	--	---	---